



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	11.01.2013
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Sadik Thaçi Menaxher i Prokurimit në komunën e Kamenicës
<b>CC:</b>	z. Shaip Surdulli Kryetar i Komunës së Kamenicës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion për tenderin "Dhënia me Koncesion e Vendgjahishtës në Kamenicë"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Dhënia me Koncesion e Vendgjahishtës në Kamenicë" me numër prokurimit me nr. 653-12-063-621 from këtë:

**OPINION**

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, (në tekstin e mëtejme AK), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik "Dhënia me Koncesion e Vendgjahishtës në Kamenicë", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-I/042 për Prokurimin Publik, Ligjin nr. 02/I-53 për Gjyctinë, Ligjin nr.02/1-2 për Procedurën Administrative, si dhe Udhëzimit nr.06/2009 për dhënie në menaxhim të vendgjuctive të përbashkëta.

## A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Komunën e Kamenicës, si autoritet kontraktues, në njoftimin për kontratë të publikuar në UEB faqen e KRPP-së me kontratë “Koncesion” të procedurës së hapur vlerë e mesme me nr.pr 653-12-063-621 dhe titull tenderi “Dhënia me Koncesion e Vend gjahishtës në Kamenicë” të pika III.2.1 Kërkesat për Përshatshmëri pika 5. Ka kërkuar: Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme- për subjektet tjera juridike dhe fizike si në : Pylltari, bujqësi, veterinë dhe ekologji, dhe pika 4. Një vërtetim nga shoqata mirëpo të njëjtat kërkesa nuk i ka inkorporuar në Dosje të tenderit dhe në Raportin e Vlerësimit, nga kjo rrjedh se departamenti i prokurimit ka bërë shkelje të nenit **59.4 LPP-së 04/L-042.**

Zyra e prokurimit në Komunën e Kamenicës, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit, te PJESA C, Formulari i dorëzimit tenderit te pika 4 ka plotësuar validitetin e ofertës për një periudhë prej 60 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderit edhe pse kjo pikë është obligim i Operatorit Ekonomik gjë që kjo është në kundërshtim me **nenin 20 Rregullores për Prokurim Publik** .

Më datë 29.04.2012 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka bërë kërkesë zyrës së Prokurimit që në afat sa më të shkurtër të mundshëm të shpallë tenderin për dhënie me qira vende gjuetinë e themeluar nga Kuvendi Komunal. Dhënia me qira duhet të bazohet në Ligjin për Gjuetinë **nr.02/L-53** dhe **U.A nr. 06/2009** për dhënie në menaxhim të vend gjuetisë të përbashkëta me qira.

Zyra e Prokurimit ka iniciuar këtë procedurë të prokurimit, në njoftimin për kontratë të datës 23.10.2012 dhe në Dosje të tenderit të njëjtës datë ka cekur titullin e kontratës “ Dhënia me Koncesion e Vendgjahishtës në Kamenicë”, edhe pse sipas Ligjit të Gjuetisë 02/L-53, vendimin për dhënien e Vend gjuetisë me koncesion e merr ministria në bazë të procedurës së tenderimit publik.

Vendgjuetitë e Përbashkëta sipas neni 34.1 të Ligjit të Gjuetisë 02/L-53 dhe nenit 2 të Udhëzimit Administrativ 06/2009 duhet të dhënë me qira në afat kohor prej 10 viteve, e jo si ka vepruar Autoriteti Kontraktues me rasti e shpalljes së tenderit ku ka cekur Dhënia me koncesion e vendëgjahishtës në Kamenicë.

Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit në bazë të Ligjit 02/L-53 dhe Udhëzimit Administrativ 06/2009 duhet të përcaktoj çmimin fillestar të qirasë për vend -gjueti i



cili çmim fillestar i vend gjuetisë përcaktohet prej 30 % të vlerës së kafshëve të egra të paraqitura në aktin e themelimit të vend – gjuetisë së objekteve teknike dhe përcjellëse ekzistuese, nga kjo rrjedh se A.K ka dështuar të paraqes vlerën fillestare gjë që kjo paraqet shkelje të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ 06/2009.

Gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve A.K i ka vlerësuar si të përparësishëm administrativisht të gjithë operatorët konkurrues.

#### **O.E “ FAIR HUNT ” –**

Një deklaram (Listë) të stafit të angazhuar për këtë projekt e obligueshme një (1) Biolog, 1 Agronom ose Veterinar) - O.E ka ofruar kontratën dhe diplomën për Agronom ose Veterinar ku si punëtor të kësaj kompanie figuron Z. Bajram Batusha i cili njëkohësisht është edhe Shef për Politika Menaxhuese me Kafshë të Egra, Gjuetise dhe Eko-turizmi dhe Kryetar i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të Komunave lidhur me dhënien me qira të Vendëgjahishtëve në MBPZHR . Operatori ekonomik në fjalë nuk ka ofruar dëshminë për stafin e angazhuar si **Biolog**.

Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme për subjektet tjera juridike dhe fizike si në : Pylltari, bujqësi, veterinë dhe ekologji, dhe një vërtetim nga Shoqata i cili është kërkuar në Njoftimin për Kontratë të UEB faqes së KRPP-së.

Lista e rojeve të kërkuara min. (2) roje është ofruar nga operatori por nuk kanë kontrata dhe diploma të vulosura ashtu si janë kërkuar .

O.E “ Fair Hunt” te pjesa I Formulari i tenderit pika 3 Çmimi total i tenderit me shifra 180,300.00 € dhe me fjalë Njëqind e tetëdhjetëmijë e trecinë euro, ndërsa të përshkrimi i çmimit për 10 vite x 3000 € = 30.000 €.

Autoriteti Kontraktues me rastin e hapjes së tenderit në procesverbalin e hapjes ka lexuar çmimin prej përshkrimit të çmimit me vlerë prej 30.000 € e jo çmimin prej 180,300.00 € ashtu si ishte në formular të tenderit.

Në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe komisioni i vlerësimit, i cili gjatë vlerësimit të këtij tenderi ka vlerësuar O.E “ Fair Hunt” me çmime prej 30.000 €.

Më datë 22.11.2012 Autoriteti Kontraktues ka përgatit Letër Standarde për sqarimin e tenderit si në vijim:

Kërkojmë nga ju që të sqaroni çmimin e dhen në ofertë ngase në formularin e ofertës keni dhënë çmim prej 180,300.00 € ndërsa tek formulari i çmimit për qira 30,000.00 €. Andaj kërkohet që të deklaroni me shkrim.

Më datë 23.11.2012 O.E “ Fair Hunt” ( Kreshnik Sadiku nën autorizimin e Kurt Hofer dhe Fair Hunt) jep sqarimin e tij:



Shuma e përgjithshëm e investimit tonë është 180,300.00 € ku qiraja për 10 vite është e përfshirë në këtë shumë.

Qiraja për komunë do të jetë 30,000.00 € (për dhjetë vite) ndërsa investimet tjera do të jenë në shumën prej 150,300.00 € që në total japin shumën 180,300.00 €.

**O.E “Qendra Kopshtare”** – Kamenicë - nuk kishte dokumentacionin e kompletuar ngase i mungon :

Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme për subjektet tjera juridike dhe fizike si në : Pylltari, bujqësi, veterinë dhe ekologji, dhe një vërtetim nga Shoqata i cili është kërkuar në Njoftimin për Kontratë të UEB faqes së KRPP-së.

Konstatim A.K me rastin e vlerësimit të tenderit në fjalë nuk ka bere vlerësim të rregullt sipas LPP-së ngase ka vlerësuar ofertat e Operatorëve Ekonomik si të kompletuara edhe pse nga vlerësimi i ofertave rezulton se vetëm një operator ekonomikë është i përgjegjshëm administrativisht, me një veprim te tille A.K ka ber shkelje të nenit **59** respektivisht nenit 32 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit ka përgatit specifikimin e çmimit vetëm për pjesën e qirasë ndërsa te gjitha investimet te cilat parashihen në këtë projekt janë obligime të O.E në bazë të projekt propozimit të tyre.

Njësia e kërkesës ka kërkuar qe në dosje të tenderit të inkorporohet edhe vlera fillestare është 22.138 €, cila vlerë nxirret duke shumëzuara me 30% ë vlerës mesatare të gjitha kafshëve të egra.

Zyra e prokurimit me rastin e përgatitjes së Dosjes së tenderi nuk ka paraqitur fare vlerën fillestare e përcaktuar me ligj dhe sipërfaqen e përgjithshme të vend gjuetisë gjë që kjo është në kundërshtim me nenin **35 Ligjit 02/L-53**.

Komuna e Kamenicës në bazë të vendimit 01.Nr.08 më datë 31.01.2011 nxjerr vendim për Themelimin e Ven gjuetisë në Territorin e Komunës së Kamenicës, në kuadër të këtij vendimi Kuvendi Komunal ka miratuar edhe listën e shtazëve të egra dhe shpezëve të egra sipas emrit , poenëve dhe çmimit për Kompensimin e dëmshpërblimit por nuk ka bërë numrin e kafshëve te egra. Ne vendim janë cekur një numër me i gjer i shtazëve të egra si p.sh: Kaprolli prej 7 llojesh me poenë të ndryshëm dhe çmime të ndryshëm, Derri prej 10 copësh me poen të ndryshëm dhe çmime të ndryshëm.

Andaj zyra e prokurimit me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit nuk ka përcaktuar se për cilin lloje te kaprollit dhe derrit te egër duhet ofertohet nga ana e ofertuese. Nga kjo kuptohet se A.K ka përpiloi specifikime me qasje jo te drejte për këtë aktivitet te prokurimit

Si rezultat i mos respektimit te ligjeve te cekura me larte dhe udhëzimit administrativ, autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të kriterëve për dhënie e kontratës ku çmimi është poentuar 60% dhe operimin, mirëmbajtjen dhe shpenzimet e tjera të përditshme 40%, Agjencia kundër

Korrupsionit pas verifikimit, krahasimit dhe ekzaminimit të oferteve konkurruese ne bazë te këtyre kritereve të caktuar konstaton se:

Operatoret ekonomik me rastin e tenderimit në këtë tender kanë ofertuar në këtë mënyrë: O.E “ Fair Funt” -30000 €, Qendra Kopshtare 8700 € dhe Shoqata e Gjuetarëve “ Thëllënza” 6000 €.

O.E në këtë tender te Pjesa 2 shtimi i fondit të Kafshëve kanë ofertuar në këtë mënyrë: O.E “ FAIR FUNT” - 1522 copë, O.E” Qendra Kopshtare” – 1074 copë, Shoqata “ Thëllënza” – 6461 copë.

O.E në këtë tender te Pjesa 3 shtimi i fondit të Kafshëve kanë ofertuar në këtë mënyrë (O.E “ FAIR FUNT” - 95 copë, O.E” Qendra Kopshtare” – 89 copë, Shoqata “ Thëllënza” – 922 copë.

Me respekt!